



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Rendit Publik

Ministria e Shendetesise

Nr. 978 date 5.5.2003

Nr. 1573, date 5.5.2003

Prokuroria e Pergjithshme

Nr. 870, date 03.04.2003

**UDHËZIM I PËRBASHKËT
PËR**

**RUAJTJEN, ADMINISTRIMIN DHE TEKNIKAT E ASGJËSIMIT TE
SUBSTANCAVE NARKOTIKE E PSIKOTROPE
TE SEKUESTRUARA**

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutës; te nenit 8, pika 2 te Ligjit nr. 8737, date 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë" re nenit 28 te Ligjit nr. 8750, date 26.03.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut te substancave narkotike ose psikotrope.

U D H Ë Z O J M Ë :

1. Substancat narkotike ose psikotrope si dhe prekursorët që sekuestrohen nga prokurora, policia gjyqësore e Policisë së Shtetit dhe, ose e doganave administrohen dhe ruhen mjedise të siguruara në drejtorinë e policisë në qarqe, sipas urdhrit të prokurorit përkatës.
2. Ruajtja dhe administrimi i substancave të përmendura në pikën 1 të këtij Udhëzimi shoqërohet me këto dokumente:
 - a. Kopje e procès-verbal të sekuestrimit.
 - b. Kopje e vendimi për marrjen e mostrës për ekspertim si dhe sasia e marre;

- c. Numrin e procedimit penal dhe, kur dihen personat e proceduar penalisht, shënohen edhe emrat e tyre;
- d. Urdhrin i prokurorit për ruajtjen dhe administrimin.

3. Mjedise te siguruara konsiderohen ambientet brenda territorit te drejtorisë se policisë se qarkut, qe garantojnë shkalle te larte sigurie, Këto mjedise mbyllen me dy brava me çelësa te ndryshëm, ku njeri administrohet nga shefi i policisë kriminale te drejtorisë se policisë se qarkut dhe tjetri nga shefi i zyrës rajonale te luftës kundër drogës

4. Ne raste kur për shkak te cilësive te veçanta apo te sasive te mëdha te substancave narkotike apo psikotrope si dhe prekursorëve te sekuestruara, ato nuk mund te ruhen ne ambientet e sipërpërmendura. prokurona vendos te ruhen ne një ambient tjetër apo te asgjësohen, sipas dispozitave përkatëse te Kodit te Procedurës Penale.

5. Prokurori qe ndjek procedimin përkatës, ne çdo rast kur ka te sekuestruara ne cilësinë e provës materiale lende narkotike apo psikotrope dhe prekursorë, i kërkon gjykatës te shprehet me vendim për destinacioni e tyre. si me poshtë;

- a. Ne rastet kur lendet e sekuestruara janë te papërdorshme. kërkon asgjësimin e tyre;
- b. Ne rastet kur lendet e mësipërme mund te shërbejnë si barna te përdorshme me konfeksion te rregullt dhe te paskaduara dhe kërkohe nga Ministria e Shendetesise. kërkon kalimin e tyre ne administrim te Ministrisë se Shendetesise:
- c. Ne rastet kur ka kërkesë nga Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës kërkon kalimin ne administrim te Institutit te Mbarështimit dhe Përgatitjes se Qenve te Policisë, ne sasi te përcaktuara te këtyre substancave. me qellim përdorimin për stërvitjen e qenve te drogës. Kur këto lende nuk mund te përdoren për këtë qellim, ato asgjësohen menjëherë.
- d. Ne rastet kur Ministria e Shendetesise, për arsye studimore e shkencore, kërkon Shërbimit Qendror te Luftës Kundër Drogës. Kalimin e sasive te kufizuara te këtyre lendeve dhe ky t fundit i drejtohet prokurorisë

6. Asgjësimi i substancave narkotike ose psikotrope dhe prekursorëve te sekuestruara dhe te mostrave te tyre behet me procesverbal ne prani te prokurorit te ekzekutimin te vendimeve, te oficerit te policisë gjyqësore dhe personit te autorizuar nga gjykata i cili duhet te shprehet ne vendimin gjyqësor.

6.1. Procesverbali i asgjësimit, sipas formularit bashkëlidhur këtij Udhëzimi të Përbashkët, përpilohet në tre kopje, një kopje i dërgohet gjykatës, një kopje administrohet nga prokurori i ekzekutimit të vendimeve dhe kopja e tretë administrohet nga oficeri i policisë gjyqësore.

6.2. Në çdo rast asgjësimi, Ministria e Shëndetësisë përcakton një specialist që do të këshillojë mënyrën e asgjësimit të lendeve të sekuestruara, me qëllim për të mos ndorur ambientin dhe për të mos dëmtuar personat që do të marrin pjesë. Këshilla e specialistit përshkruhet në procesverbal dhe nënshkruhet prej tij.

7. Në rastet kur janë sekuestruar substanca narkotike, psikotrope apo prekusoret e tyre dhe nuk ka autore të proceduar, pas kryerjes së ekspertimeve të nevojshme, të drejtën për të vendosur për destinacionin e këtyre sasive e ka prokurori. Ai vendos për asgjësimin apo kalimin e tyre në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë, apo Institutit të Mbarëshimit dhe Përgatitjes së Qenve, kur për këtë të fundit ka kërkesa për përgatitjen e qenve të drogës,

8. Kane të drejtë të ushtrojnë kontrolle për masat e marra për mbajtjen dhe administrimin e substancave narkotike apo psikotrope si dhe prekusorëve të tyre:

- a. Drejtuesi i prokurorisë dhe prokuroret e ekzekutimeve të vendimeve penale; Prokuroret e autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm
- b. Drejtoret e drejtorive të policisë në qarqe;
- c. Punonjësit e policisë të Shërbimit Qendror të Luftës Kundër Drogës;
- d. Personi i autorizuar nga Ministri i Rendit Publik apo Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- e. Grupe pune të përbashkëta të përcaktuara nga titullarët e Prokurorisë së Përgjithshme Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Shëndetësisë.

9. Me këtë Udhëzim të Përbashkët të njihen prokuroret, punonjësit e Policisë së Shtetit si dhe personeli i strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë që kanë detyrime për zbatimin e tij.


10. Me kontrollon e zbatimit te këtij Udhëzimi te Përbashkët ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Shendetesise.

11. Ky Udhëzim i Përbashkët hyn ne fuqi menjëherë

MINISTRI I SHENDETESISE
Mustafa HANA

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Luan RAMA

PROKURORIA PERGJITHSHEME
Theodhor SOLLAKU

The image shows three official stamps and signatures. The top left stamp is for the Ministry of Health (Ministria e Shendetesise) with the signature of Mustafa HANA. The top right stamp is for the Ministry of Public Order (Ministria e Rendit Publik) with the signature of Luan RAMA. The bottom stamp is for the General Prosecutor's Office (Prokuroria e Pergjithshme) with the signature of Theodhor SOLLAKU. All stamps are circular and contain the coat of arms of Albania.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SE SHKALLES SE PARE

POÇES-VERBAL

Mbi asgjësimin e provave materiale

Ne _____ me datën _____, ne zbatim te vendimit te Gjykatës Nr_ __ _date_____ qe bën fjale për shqyrtimin e procedimit penal me Nr _____ date _____ . _____ . _____ ne ngarkim te:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

si dhe Urdhrit te Prokurorit te ekzekutimeve te vendimeve penale Nr _____ date _____ .

Komisioni i përbëre nga

1. _____
(Emri, Mbiemri, Funkzioni, Institucioni)
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Pasi ka marre ne dorëzim provat materiale _____ sasinë, llojin) përpilon këtë procesverbal ne vendin e quajtur _____ për asgjësimin e _____ (sasia) te drogës

_____ (lloji) përcaktuar ne aktin e ekspertimit Nr _____ date _____
 te _____ (emri i Laboratorit qe ka bere ekspertimin)
 Asgjësimi i provës materiale behet ne përputhje me nenin 190 germa c te
 Kodit te Procedurës Penale dhe pikës 6 te Udhëzimit te Përbashkët Nr _____
 date _____.

Asgjësimi i sasisë se drogës se Lartpërmendur behet _____
 (v i h e n m ë n y r a t e a s g j ë s i m i t) sipas këshillës se specialistit
 perkates _____

Ky procesverbal mbahet ne 3 kopje nga te cilat

(pershknihet institucioni qe i merr).

Komisioni i asgjësimit te proves materiale

Emer Mbiemri

Funksioni

Nenshkrimi

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

